



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

**C-IV-13-1415**

*Parashtruesi i Ankesës*

**B. R,** Prishtinë

*Kundër*

*Pala kundërshtare*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) ( NSH “E..” në likuidim), Rr. “Agim Ramadani” nr. 23, Prishtinë**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 11 mars 2020, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN092-0096 i datës 4 korrik 2013.**
- III. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 31 korrik 2013, pranë DHPGJS, është parashtruar një kërkesë për rishikim të Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN092-0096 i datës 4 korrik 2013 (tani e tutje: Vendimi), me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për pagat e papaguara, për periudhën nga viti 1993 e gjer në vitin 1999, në vlerë prej 10,453.29 ( një zero katër pesë tre dy nënte ) Euro, nga NSH “E..” (në likuidim).

Anukesi pohon se kërkesa e tij kreditore i përket periudhës nga 23 gusht 1995 e gjer me 10 qershor 1999. Anukesi kundërshton vendimin në kuptim të asaj se AL ka zbatuar gabimisht

dispozitat ligjore. Nga gjitha arsyet propozoj që të prishet vendimi dhe të obligohet AL dhe që të rishqyrtoj kërkesën.

Ankesës i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL-së.

AKP me 14 nëntor 2017, parashtroj përgjigjen.

AKP e kundërshtoj në tërësi pohimet e ankuesit si të pabazuara. AKP pohon se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në kuptim të dispozitave të Ligjit mbi AKP dhe si e tillë, sipas saj, kërkesa kreditore e ankuesit nuk i ka plotësuar kushtet ligjore sipas dispozitave të Shtojcës së Ligjit për AKP. Nga të gjitha arsyet e cekura, AKP propozon që ankesa të refuzohet si e papranueshme ose të pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Përgjigja e AKP ju dorëzua ankuesit me 17 nëntor 2017.

Ankuesi nuk parashtroj përgjigje.

### **Arsyetimi Ligjor**

Ankesa është e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi, kërkon kompensimin e pagave për periudhën nga 23 gusht 1995 gjer në Qershor 1999.

Gjykata konstatoj se, në rastin konkret duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 parashihet se punëtorëve ju takon e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Nga dispozita e lartëcekur, mund të konkludohet se, punëtori gëzon të drejtën në dëmshpërblim nëse:

- a. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit të saj,
- b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë e Vendimit të AL, dhe
- c. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Nga ankesa nuk mund të vërtetohet se ankuesi ka përmbushur njërin nga kushtet e parapara ligjore, me qëllim që të gëzonte të drejtën në kompensimin e të ardhurave personale.

Ankuesi, pavarësisht pretendimeve të tij, nuk ka arritur që të argumentoj se ka vazhduar punësimin duke filluar nga qershori i vitit 1999 e gjer me 2007, me çka do ti takonte edhe e

drejta e kompensimit e të ardhurave personale si rezultat i punës së tij. Më tutje ankuesi edhe përkundër saj, gjatë kësaj periudhe, asnjëherë nuk ka dëshmuar se ka inicuar procedurë gjyqësore me të cilën do të kërkonte mbrojtjen ligjore dhe do të adresonte kërkesat e tij lidhur nga mardhënia e punës, për periudhën nga viti 1995 e gjer me 1999.

Andaj ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi, fakt, apo ndonjë arsyetim ligjor që do të argumentonte dhe të dëshmonte bazueshmërinë e ankesës, ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS ( ligji nr. 06/L-086).

Barra e provave bie mbi ankuesin, që të dëshmoj se i njëjti ka plotësuar kushtet ashtu siç parashihen sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksa Gjyqësore:**

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar